

364.6:305-055.2

Gëzim Xhambazi¹

**REORGANIZIMI FAMILJAR I NDIHMËS SOCIALE – BARAZIA
GJINORE**

**СЕМЕЈНА РЕОРГАНИЗАЦИЈА ЗА СОЦИЈАЛНА ПОМОШ -
РОДОВА ЕДНАКВОСТ**

**FAMILY REORGANIZATION FOR A SOCIAL WELFARE -
GENDER EQUALITY**

Abstract

Work in the family has always been divided by gender. In traditional families social norms and rules were clearly defined in terms of likeability of the activities in the family and outside. Changes and social transformations also affected family life and work, but the roles within proved to be untouchable. Many sociologists agree that the female gender discrimination is the result of economic dependence, but this fades finding new situations where women started to be independent in economic aspect. Numerous researches in this direction suggest that domestic chores remain burden to female gender, despite the fact that many women are employed. Economic independence of women on one hand delivered them from closing indoor, and on the other hand increased their stressful situations. Care for children, dealing with new and unknown situations at workplace, discrimination and harassment of various kinds are some new situations faced by women in nowadays. The first movements about gender equality actualize at sixties of the last century, in the period of radical social and economic transformations. Time spent across the centuries that characterizes gender inequality is too long and cannot be overcome only with social adaptation to new situations. Historic compensation of injustices toward the female

¹ Doktor në studime gjinore-shkenca sociologjike, Universiteti Shtetëror i Tetovës.

gender has not been implemented by any country of the world, so the gender equality seems unreachable.

Keywords: equality, family, work.

Abstrakt

Puna në familje gjithmonë ka qenë e ndarë në bazë gjinore. Në familjet tradicionale normat dhe rregullat shoqërore ishin qartë të definuara për sa i përket pëlqyeshmërisë së aktiviteteve në familje dhe jashtë saj. Ndryshimet dhe transformimet shoqërore prekën edhe jetën dhe punën në familje, por rolet brenda saj u treguan si të paprekshme. Shumë sociologë pajtohen se diskriminimi i gjinisë femërore është rezultat i varshmërisë ekonomike, por ky konstatim zbehet me situatat e reja, ku gratë filluan të pavarësohen në aspektin ekonomik. Hulumtimet e shumta në këtë drejtim na bëjnë me dije se punët në familje vazhdojnë të mbeten barrë e gjinisë femërore edhe përpos faktit se shumë prej grave janë të punësuar. Pavarësimi ekonomik i grave në një rëndësi të çliroi ata nga mbyllja shtëpiake, kurse nga ana tjetër ua shtoi situatat stresuese. Kujdesi për fëmijët, ballafaqimi me situatat e reja dhe të panjohura në vendin e punës, diskriminimet dhe ngacmimet e llojeve të ndryshme janë disa nga situatat e reja me të cilat përballen gratë në ditët e sotme. Lëvizjet e para mbi barazinë gjinore aktualizohen kah vitet gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar, në periudhën e transformimeve rrënjësore ekonomike dhe shoqërore. Koha e kaluar shekullore të cilën e karakterizon pabarazia gjinore është shumë e gjatë dhe nuk mund të tejkalohet vetëm me përshtatjen sociale ndaj situatave të reja. Kompensimi historik i padrejtësive ndaj gjinisë femërore nuk është zbatuar nga asnjë vend i botës, prandaj edhe barabarësia në aspekt gjinor duket e pa arritshme.

Fjalë kyçe: *barabarësi, familje, punë.*

1. Dilemat rreth barazisë dhe barabarësisë gjinore

Dallimet në strukturën shoqërore përbëjnë bazën e ndryshimeve dhe përfaqësojnë shtytësin kryesorë drejt zhvillimeve. Ky konstatim mbetet i një anshëm për arsye se zhvillimi si pasojë e luftës së përherëshme, kryesisht ndërmjet klasave, disa pjesëtarë të të njëjtit grup i anashkalon duke injoruar mundësitë, vlerat apo të drejtat e tyre. Dhe kur pakënaqësia brenda grupit kulmon, atëherë vjen deri te domosdoshmëria për ndryshime tjera. Tentativat për rregullim ligjor të shumë

çështjeve specifike që kanë të bëjnë me të drejtat, liritë dhe barazitë mes njerëzve, mbesin me karakter deklarativ.

Shumë prej studiuesve të shkencave shoqërore dhe humane arrijnë në pajtueshmëri dhe kanë pikëpamje të njëjta rreth dominimit të përhershëm në shoqëri nga ana e burrave. Hulumtimet e shumta në këtë sferë bëjnë me dije se nuk ekziston shoqëri në mbarë botën e cila dominohet nga femrat. Lëvizjet e shumta nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar, me qëllim të përafrimit social shoqërorë japin rezultate pozitive, por ende janë larg qëllimit final. Shikuar nga aspekti gjinor, të drejtat e grave dhe statusi i tyre social nuk kundërshtohet nga askush, kurse nga ana tjetër nuk ekziston një recetë sipas së cilës do të rregullohej kjo problematikë.

Barazia gjinore mbështetet në konceptin se burrat dhe gratë janë të lirë ti zhvillojnë aftësitë personale. Kjo do të thotë se sjelljet e ndryshme, aspiratat dhe nevojat e burrave dhe grave respektohen, merren parasysh, vlerësohen dhe ndihmohen në mënyrë të barabartë. Të drejtat, mundësitë dhe përgjegjësitë nuk duhet të varen nga stereotipat e caktuar, paragjykimet apo rolet gjinore, gjegjësisht të qenët burrë ose grua nuk duhet të paraqesë asnjëfarë pengese në çdo sferë të jetës. Në kontekst të drejtave ndërkombëtare të njeriut, koncepti juridik i barazisë gjinore përmbahet në deklaratën Universale për të drejtat e njeriut prej vitit 1948, si dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara (1979) për eliminim të të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave. Konventë e ratifikuar nga 100 vende, e cila në mënyrë të qartë thekson se “Diskriminimi i grave i lëndon parimet e barazisë, të të drejtave dhe respektit ndaj dinjitetit njerëzor”.² Qeveritë botërore e vërtetuan angazhimin e tyre për të drejta të barabarta mes burrave dhe grave në Deklaratën e Pekinit (1995) dhe Platformën për aksion. Kjo është periudha kur lëvizjet për të drejtat e njeriut, në veçanti për të drejtat e grave aktualizohen në shumë vende të botës.

Barabarësia gjinore nënkupton drejtësi gjatë trajtimit të burrave dhe grave, në pajtueshmëri me nevojat e tyre të veçanta. Ky koncept përmban trajtim të diferencuar, por ai njëkohësisht llogaritet si i drejtë në aspekt të drejtave, fitimeve, obligimeve dhe mundësive. Në kontekst zhvillimor, qëllimi i barabarësisë gjinore më shpesh kërkon masa të posaçme për të kompensuar padrejtësinë dhe handicapimin historik dhe

² Ивановска, М. (2007), *Водич во феминистичката и родовата терминологија*, Здружение на граѓани-Акција здруженска, Скопје, f.71

social të grave. Barabarësia gjinore ka të bëjë me përparimin e barazisë personale, sociale, kulturore, politike dhe ekonomike të të gjithë pjesëtarëve në shoqëri. Arritja e një kompromisi mes grupeve kërkon qasje të ndryshme, pabarazia gjinore nuk mund të tejkalohet me mekanizma të njëjtë sikurse pabarazia racore, nacionale apo fetare.

Me qëllim sigurimin e mundësive reale për burrat dhe për gratë, duhet të bëhet reorganizim thelbësor institucional, me theks të veçantë në: investimet sociale në kuadër të kujdesit të fëmijëve; mungesës nga puna, të nënës ose babait, në periudhën e lidjes; orar pune më fleksibil; ndarja e punëve varësisht ndryshimeve tjera të cilat imponohen si të patjetërsueshme me qëllim të arritjes së baraspeshës mes jetës publike dhe private, etj.

2. Martesa, fëmijët dhe puna në rrjedhën e transformimeve shoqërore

Sipas shumë sociologëve, martesa gjatë shekullit XX pësoi dy transformime rrënjësore. E para ndodhi në gjysmën e parë të shekullit njëzet e njohur në sociologji si *“kalim prej institucioni në partneritet”*. Në martesën institucionale marrëdhëniet martesore dhe familjare ishin nën ndikim të fuqishëm të normave fetare, ligjore dhe të traditës. Me zvogëlimin e ndikimit të këtyre faktorëve, paraqitet një model i ri martese i njohur si *“Martesë partneriale”*. Esenca e kësaj martese është dashuria, kurse bashkëshortët kanë role të ndara, ku burri kryesisht kujdeset për sigurimin e nevojave ekonomike, kurse gruaja për fëmijët dhe familjen. Pas viteve gjashtëdhjeta të shekullit njëzet, martesa pëson ndryshim tjetër rrënjësor. Tani gratë vazhdojnë të punësohen pavarësisht lindjes së fëmijëve, rritet numri i divorceve, martesat lidhen në moshë më të vonshme, dukshëm fillon të bie nataliteti, etj. Me këto ndryshime, martesa partneriale nuk ishte më ideale për kulturën e vendeve të zhvilluara, rolet e burrave dhe grave filluan të ndryshojnë duke rezultuar me një model të ri martese, e njohur si *“Martesë individualiste”*.³ Sipas këtij modeli, martesa është vetëm njëra prej opsioneve të njerëzve e cila mund tu shërbejë për modelim të jetëve private. Tani normat shoqërore kanë shumë më pak ndikim në rregullimin e marrëdhënieve martesore dhe familjare, në krahasim me kohën e martesës partneriale. Kjo gjendje rezulton me rritjen e numrit të fëmijëve të

³ Term i përdorur për herë të parë nga Cherlin në fund të shekullit njëzet. Më tepër shih: Cherlin, A., *American Marriage in the Early Twenty-First Century, Future of Children*, Vol. 15, No. 2, Fall 2005, f.41-61.

lindur në bashkësi jashtëmartesore, bashkëjetesës jashtëmartesore si dhe të lidhjeve jashtëmartesore (*living apart together*) e cila sa vjen e bëhet si alternativë e vërtetë e martesës. Sipas Levinit, kjo bashkësi e re përmban tre elemente: te çifti të ekzistojë pajtueshmëri se janë në lidhje dhe se përfaqësojnë çift, të tjerët ti llogarisin si çift dhe mbi të gjitha të mos bashkëjetojnë.⁴

Transformimet që pësoi martesë nuk anashkaluan edhe rolet gjinore brenda familjes. Nëse në familjen tradicionale, në veçanti në ato rurale, lidhjet fqinjësore dhe farefisnore ishin shumë të fuqishme, po aq i fuqishëm ishte edhe roli dominues i burrave. Zhvillimi i shoqërisë pati hov më të madh me fillimin e industrializimit dhe urbanizimit, ku shumë familje nga fshatrat migruan në qytete, me çka lidhjet fqinjësore u zbehën, kurse familjet u ballafaquan me probleme të reja dhe të panjohura. Kërkimet sociologjike na tregojnë se në këtë rast gratë u ballafaquan me vështirësi më të mëdha, dhe në asnjë rast nuk u trajtuan në mënyrë të barabartë me burrat. Njëra prej çështjeve më esenciale me të cilën u ballafaquan familjet ishte nevoja për të përballuar mënyrën e re të jetesës. Në këto rrethana, shumë prej grave ishin të detyruara të punojnë edhe jashtë shtëpisë, kurse nga ana tjetër duhej të kujdesen edhe për fëmijët. Në këtë rast duhej të rridefinohen rolet gjinore brenda familjes dhe në mbarë shoqërinë. Shumë prej grave (nëna) punësoheshin shumë lehtë, për arsye se: 1. Gratë paguheshin më pak se burrat për punën e njëjtë. Kjo motivonte punëdhënësit që të punësojnë sa më shumë gra dhe të përfitojnë më shumë. Në ShBA, gruaja me nivel arsimimi të njëjtë me burrin në vitin 1965 është paguar sa 60-65% në krahasim me fitimin e burrit. Në vitin 1991 ky proporcion ulet, por gruaja vazhdon të paguhet më pak se burri, tani ajo paguhet vetëm 72% në krahasim me burrin. E njëjta gjendje është edhe në Gjermani, ku në vitin 1991 gratë fitonin 73% nga ajo sa fitonin burrat për punën e njëjtë; 2. Faktor i rëndësishëm për punësimin e grave ishte fleksibiliteti i tyre në punësim. Sipas shumë hulumtimeve, pjesa më e madhe e kërkuesve të punëve me orar të shkurtuar janë gra, veçanërisht nëna. Në shoqëritë post moderne një gjë e këtillë është mjaft e kërkuar dhe e pëlqyer nga ana e punëdhënësve, për arsye se fleksibiliteti i orarit të punës është

⁴ Hulumtimet flasin se në vitin 1993 në Suedi ka pasur 60000 lidhje të këtilla, kurse pas tetë vjetësh, në vitin 2001 ka pasur 150000 lidhje jashtë martesore. Më tepër: Levin, I., *Living Apart Together: A New Family Form*, *Current Sociology*, Vol. 52, No. 2, March 2004, f.222-227

njëra prej karakteristikave themelore të ekonomive informatike.⁵ Nevoja për punëtorë me orar të pjesshëm (*part time*) sa vjen e rritet, dhe përfaqëson një dukuri shumë të përhapur në vendet e zhvilluara.

Nga krejt këto situata të reja me të cilat ballafaqohen familjet e sotshme, vlen të theksohet se ndryshimi i rolit të burrave në familje ngec në krahasim me ndryshimet që ndodhin si pasojë e punësimit të grave. Dallimi mes grave të punësuara dhe atyre të papunësuara në kryerjen e punëve shtëpiake është i vogël. Grenshtain arriti në përfundim se gratë e punësuara kryejnë rreth 72% e punëve shtëpiake, kurse gratë e papunësuara kryejnë 81% e punëve shtëpiake.⁶ Në këtë rast duhet theksuar se burrat zakonisht merren me aktivitete shtëpiake të cilat në njëfarë mënyre u përfaqësojnë edhe kënaqësi, ata preferojnë të luajnë dhe zbatohen me fëmijët, presin barin, kryejnë përmirësime të imta amvisërie, etj. Pavarësisht zhvillimit ekonomik të shoqërive, e përbashkëta e të gjithave është se gratë e punësuara edhe pse për punën e njëjtë paguhen më pak se burrat, ata i përkushtohen shumë punës, pasi që puna si aktivitet profesional u përfaqëson edhe kënaqësi. Numri i grave (nëna) që janë të mbingarkuara si pasojë e punëve të përditshme dhe me *dy ndërrime* është i madh. Kjo do të thotë se me mbarimin e ndërrimit të parë (në punë), gratë fillojnë me ndërrimin e dytë në shtëpi. Për këtë arsye, nuk duket shqetësues fakti, sipas të cilit tre nga katër gra amerikane të moshës prej 18 deri 54 vjeç përjetojnë stres duke tentuar që për secilin të bëjnë gjithçka.⁷

Në diskutimet e sotshme rreth vlerave familjare, dominojnë dy drejtime diametralisht të kundërta, konservative dhe liberale. Të parët mendojnë se në familjen bashkëkohore ekziston krizë serioze në martesë dhe në familje, dhe se detyrë thelbësore e drejtësisë është ruajtja e modelit familjar i cili bazohet në familje nukleare (e përbërë prej çiftit bashkëshortor dhe fëmijëve). Përkundër tyre, liberalët janë të mendimit se familja bashkëkohore nuk është në krizë, por është në proces tranzicioni dhe adaptimi ndaj ndryshimeve globale të cilat godasin edhe familjen. Për këtë arsye, ata nuk kërkojnë drejtësi të mbrojtë modelin e

⁵ Më tepër: Castells, M., (1999), *The Power of Identity*, Blackwell Publishers, London, f.169-173

⁶ Ситуаг нѐ: Мицковиќ, Д., (2008), *Семејството во Европа XVI-XXI век*, Културна установа Блесок, Скопје, f.243

⁷ Marrë nga: Јашари, X., (2007), *Социологијата и родот: Мажите и жените во современото општество*, Евро-Балкан Пресс, Скопје, f. 243-244

familjes nukleare, por pretendojnë në pranim dhe rregullim legjislativ të pluralizimit të modelit nuklear, i cili përfaqëson karakteristikë themelore të familjes bashkëkohore.

Ndryshimet në legjislativë kanë mundësuar përmirësim në trajtimin institucional të grave, edhe pse shumë nga deklaratat e ratifikuara me karakter ndërkombëtarë mbeten vetëm në letër. Vlen të theksohet se shumë nga çështjet familjare, sidomos mbi të drejtën e trashëgimisë, ndarjes së pasurisë në rast divorci, përkujdesjes për fëmijët, etj., janë dukshëm të përmirësuara dhe në favor të grave. Nga ana tjetër barabarësia gjinore, ose kompensim i dëmit historik shekullor ndaj grave nuk është realizuar në asnjë vend të botës. Ky mund të jetë një ndër shkaqet më të forta për vazhdimësinë e pabarazisë gjinore.

Përfundim

Në literaturën e shumtë që trajton çështjet gjinore në shoqëri, ekziston bindja se dallimet gjinore janë rezultat i biologjisë, gjegjësisht i dallimeve biologjike, kurse të tjerët janë të mendimit se këto dallime vijnë si rezultat i ndërtimit social të individëve. Tradita, normat morale dhe ngritja kulturore në përgjithësi janë shkak i fuqishëm mbi transmetimin e vlerave të gjeneratave të reja. Pika ku të gjithë pajtohen është ndarja e punëve dhe vlera e punëve. Deri vonë mendohej se arsyeja e nënçmimit, përbuzjes dhe diskriminimit të grave vjen si pasojë e varësisë ekonomike. Punësimi i shumë grave, mundësoi pavarësim ekonomik, por nuk i çliroi ato nga paragjykimet dhe stereotipizimet e shumta. Gratë e punësuara çdo ditë ballafaqohen me padrejtësi të ndryshme, ngacmime dhe kushtëzime në vendin e punës, përkujdesje të shtuar ndaj familjes, etj.

Conclusion

In the voluminous literature that addresses gender issues in society, there is a belief that gender differences are the result of biology, i.e. the biological differences, while others are of the opinion that these differences are the result of social construction of individuals. Tradition, moral standards and cultural establishment in general are more powerful cause on transmission of values to the younger generation. The point at which all agree is the division of labor and the value of work. Until recently it was thought that the reason of humiliation, contempt and discrimination against women is a result of economic dependence. Employing more women, economic independence enabled, but

not delivered them from the many prejudices and stereotypes. Employed women face different injustices every day, harassment and blackmail in the workplace, added care to the family, etc.

Literatura e shfrytëzuar

1. Campbell, A., Men, women, and aggression. Basic Books, New York, 1993
2. Castells, M., The Power of Identity, Blackwell Publishers, London, 1999
3. Cherlin, A., American Marriage in the Early Twenty-First Century, *Future of Children*, Vol. 15, No. 2, Fall 2005
4. Gerson, K., How Women Decide about Work, Career, and Motherhood. Berkeley: University of California Press, 1986
5. Ивановска, М., *Водич во феминистичката и родовата терминологија*, Здружение на граѓани-Акција здруженска, Скопје, 2008
6. Јашари, Х., Социологијата и родот: Мажите и жените во современото општество, Евро-Балкан Пресс, Скопје, 2007
7. Levin, I., Living Apart Together: A New Family Form, *Current Sociology*, Vol. 52, No. 2, March 2004
8. Мицковиќ, Д., Семејството во Европа XVI-XXI век, Културна установа Блесок, Скопје, 2008